



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 72, datë 20.02.2020**

**PËR**

**NXJERRJEN NGA PËRDORIMI TË ASETEVE NË PRONËSI TË DISA GJYKATAVE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 95 e 96 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 30, datë 30.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave, si dhe në dokumentacionin e përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve si më poshtë:
  - automjetin tip “Wolswagen Bora”, me targë GJ 9283 A, viti i prodhimit 2000, në pronësi të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;
  - automjetin tip “Wolswagen Bora”, me targë VL 2190 B, viti i prodhimit 2000, në pronësi të Gjykatës së Apelit Vlorë;
  - automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë AA 816AC, viti i prodhimit 1997, në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
  - asetet (grup pajisje elektronike), sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur, në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje;
  - asetet (grup pajisje zyre dhe salla gjyqësore), sipas pasqyrave nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur, në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, gjykatat e cituara në pikën 1 të këtij vendimi dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**